

Vrojtim statistikor mbi opinionin e Shqiptarëve rreth hapjes së dosjeve të Sigurimit të Shtetit dhe Lustracionit, si dhe në vecanti mbi opinionin e shtresave të ndryshme të Ish-të Përndjekurve Politikë

Sondazhi i parë mbi opinionin e qytetarëve rreth hapjes së dosjeve të Sigurimit të Shtetit dhe Lustracionit dhe në vecanti mbi opinionin e shtresave të ndryshme të ish-të përndjekurve politikë u realizua nga Fondacioni Konrad Adenauer në bashkëpunim me Institutin për Integrimin e Ish të Përndjekurve Politikë në Tiranë, në periudhën 13 – 23 Janar 2015, me një kampion prej 1200 të anketuarish në nivel kombëtar.

Metodologjia

Për këtë sondazh u hartua një pyetësor me 15 pyetje, i cili u administrua me telefonata fikse dhe celulare. Gjithsej u anketuan 1200 banorë nga të gjitha qarqet e Shqipërisë. U anketuan vetëm shtetas, të cilet në Janar të vitit 1991 kanë qenë në moshën 16 vjeç e sipër. Kjo grupmoshë presupozohet të ketë njohuri më të sakta rreth çështjeve për të cilat u krye vrojtimi. Numri i telefonatave fikse e celulare në çdo qark u përcaktua në përpjestim me popullsinë e tyre urbane e rurale. Në përfundim të anketimit dhe hedhjes së të dhënave në bazën e të dhënave, u krye ripeshimi statistikor i kampionit, në mënyrë që ai të përfaqësonte sa më afërsisht popullsinë banuese në Shqipëri nga pikpamja gjeografike, demografike dhe politike.


Maksimumi i marzhit të gabimit statistikor rezultoi +/-3%.

Sondazhi u krye nga Dr. Eduard Zaloshnja, Pacific Institute for Research and Evaluation, Calverton, MD, U.S.A.

Profili biografik i të anketuarve

Ndër të anketuarit, **30%** deklaruan se rrjedhin nga familje të përndjekura/diskriminuara politikisht para vitit 1991 (Fig. 1). **1/4** e ish-të përndjekurve deklaruan se e kanë patur familjen në pozita të mira në pushtet ose parti para fillimit të përndjekjes/diskriminimit. Ndër të gjithë të anketuarit, rreth **12%** kanë patur të paktën një të afërm të pushkatuar politikisht (baba, nënë, burrë, grua, vëlla, motër, gjysh, gjyshe, vjehri, vjehrra, kunat, kunatë, xhaxha, dajë, hallë, ose teze). Rreth **16%** kanë qenë vetë ose kanë patur të paktën një të afërm të burgosur politikisht. Rreth **10%** kanë qenë vetë ose kanë patur të paktën një të afërm të arratisur. Rreth **21%** kanë qenë vetë ose kanë patur të paktën një të afërm të internuar/dëbuar/shpërngulur politikisht. Rreth **18%** kanë qenë vetë ose kanë patur të paktën një të afërm të shapllur “kulak” ose “të deklasuar”. Rreth **11%** kanë qenë vetë ose kanë patur të paktën një të afërm të përjashtuar nga PPSH-ja.


Fig. 1. Përqindja e të anketuarve që kanë deklaruar se familja e tyre ka qenë e përndjekur/diskriminuar para vitit 1991 dhe përqindjet e atyre që kanë qenë vetë ose kanë patur të afërm të pushkatuar/burgosur/arratisur/internuar/dëbuar/shpërngulur politikisht dhe/ose të deklasuar/kulak dhe/ose të përjashtuar nga PPSH.



Opinionii i të anketuarve mbi hapjen e dosjeve të Sigurimit dhe mbi Lustracionin


Rreth 83% e të gjithë të anketuarve mendojnë se dosjet e Sigurimit të Shtetit duhet të hapen. Në veçanti, 84% e të anketuarve me prejardhje nga familje ish-të përndjekura janë pro hapjes së dosjeve të Sigurimit (Fig. 2).

Fig. 2. A jeni dakord që të hapen dosjet e Sigurimit?




Rreth 71% e të gjithë të anketuarve mendojnë se, nëse bëhet hapja e dosjeve, duhet bërë edhe spastrimi i institucioneve publike nga ish punonjësit & bashkëpunorët e Sigurimit (edhe për lustracionin). Të të njëjtit mendim janë rreth 79% e të anketuarve me prejardhje nga familje ish-të përndjekura (Fig. 3).

Fig. 3. Nëse bëhet hapja e dosjeve, jeni vetëm për publikim të dosjeve, apo edhe për spastrim të institucioneve publike nga punonjësit & bashkëpunorët e Sigurimit?



Nëse bëhet lustracioni, 57% e të gjithë të anketuarve janë për spastrimin e të gjithë punonjësve aktualë të institucioneve publike, ndërsa 35% janë vetëm për spastrimin e drejtuesve të lartë të institucioneve aktuale. Tek të anketuarit me prejardhje nga familje ish të përndjekura, këto dy opinione janë në raportin 61% me 30% (Fig. 4).

Fig. 4. Nëse bëhet spastrimi i ish-punonjësve & bashkëpunëtorëve të Sigurimit, a duhet të largohen vetëm drejtuesit e lartë të institucioneve aktuale, edhe të mesmit, apo të gjithë që kanë patur lidhje me Sigurimin?



Shënim: Për spastrimin e institucioneve deri në nivelin e mesëm të punonjësve aktualë janë 4% e gjithë të anketuarve dhe 3% e ish-të përndjekurve